

RAPORT VJETOR I PERFORMANCËS

së Kompanive Publike të Ujësjetësimit dhe Mbeturisë në Kosovë

•2007•



WATER AND WASTE REGULATORY OFFICE
ZYRA RREGULLATORE PËR UJË DHE MBETURINA
REGULATORNI URED ZA VODU I OTPAD

Përgatitur dhe publikuar nga:
Zyra Rregulatore për Ujë dhe Mbeturina

Dizajni dhe përpunimi kompjutorik:
ADVmediaHOUSE

Shtypi:
TimeGate

Prishtinë, Qershor 2008

RAPORT VJETOR I PERFORMANCËS

së Kompanive Publike të Ujësjetësimit dhe Mbeturisë në Kosovë

● Misioni i ZRRUM-it

Misioni i ZRRUM-it është që të zbatojë rregullimin ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave të ngurta në mënyrë transparente dhe të drejtë në pajtueshmëri me praktikat e mira Europiane për tu siguruar se ofruesit e këtyre shërbimeve ofrojnë shërbime cilësore dhe me çmime të volitshme për të gjitha kategoritë e konsumatorëve në Kosovë, me respekt të plotë për mjedisin dhe shëndetin publik.

Jetësimin e këtij misioni dhe arritjen e objektivave rregullatore, ZRRUM e bën duke:

- Përcaktuar tarifat e shërbimit të cilat:
 - U mundësojnë kompanive të licencuara të ujësjellësit dhe mbeturinave që të ofrojnë shërbimet në përputhje me standardet dhe kërkesat relevante;
 - Marrin parasysh mundësitë paguese të popullatës.
- Siguruar njohuri për pikëpamjet dhe prioritetet e palëve të interesit duke u konsultuar me ta përmes shkëmbimit të informatave, memorandumeve të bashkëpunimit, mbajtjes së workshopeve të hapura, publikimit të raporteve relevante në web-faqen e vet, dhe përmes shtatë Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve;
- Bashkëpunuar me rregullatorët tjerë në Kosovë (siq janë MMPH dhe IKSHPK) për tu siguruar se përgjegjësitë e palëve të ndryshme janë të përkufizuara qartë;
- Bashkëpunuar ngushtë me rregullatorët tjerë ekonomik të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në regjion dhe në Europë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe aplikimit të praktikave më të mira;
- Siguruar se tarifat e shërbimit me të cilat ngarkohen konsumatorët janë të drejta dhe nuk bëjnë diskrimin apo demonstrojnë preferenca për cilëndo kategori të konsumatorëve;
- Siguruar se çështjet gjinore dhe të minoriteteve janë të adresuara në pajtueshmëri të plotë me legjislacionin e Kosovës;
- Publikuar informatat në mënyrë të hapur dhe transparente dhe me këtë iu mundësohet të gjitha palëve të interesit që të kuptojnë dhe participojnë në vendimet rregullatore të cilat i merr ZRRUM-i;
- Mbikqyrë dhe vlerësuar punën e kompanive të licencuara dhe duke bërë krahasime të përshtatshme në baza vjetore për performansën e tyre;
- Ndhimuar për hartimin dhe rishikimin e politikave (si p.sh. lidhur me de-rregullimin e shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave);
- Trajtuar kontestet dhe ankesat e konsumatorëve në mënyrë efektive dhe të drejtë dhe duke involvuar kompanitë e licencuara në këtë proces.

Përmbajtja e Raportit Vjetor të Performancës 2007

● Parathënie nga Drejtori i ZRRUM	4
● Parathënie nga Drejtori i IKSHPK	7
● Shkurtesat	8
● Hyrje	9
● Kualitetit i të dhënave Auditimi	11
● Performanca e Sektorit të Ujësjiellit	14
● Performanca e Ofruesit të Ujit me Shumicë	33
● Performanca e Sektorit të grumbullimit të Mbeturinave	35
● Performanca e Kompanisë për Menaxhimin e Deponive	47
● Shtojca A	50
● Shtojca B	53
● Shtojca C	57
● Shtojca D	60
● Shtojca E	62
● Shtojca F	68
● Faqja e fundit : Roli dhe Përgjegjësitë e ZRRUM-it dhe Pamje (6 foto) nga aktivitetet e ZRRUM-it në 2007	72



Viti 2007 ka qenë edhe një vit i sfidave dhe vështirësive të shumta për sektorin e shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë. Thatësia që ka mbretëruar gjatë muajve të verës së vitit të kaluar ka ndikuar drejtpërdrejt në zvogëlimin e kapaciteteve prodhuese të kompanive të ujësjellësit dhe kjo natyrisht është reflektuar me probleme në furnizimin me ujë. Kur kësaj i shtohet edhe problemi kronik i vështirësive me të cilat ballafaqohen këto kompani në arkëtimin e borxheve për shërbimet e ofruara, fitohet një pasqyrë e ambientit të pafavorshëm në të cilin kanë operuar kompanitë publike të ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë në vitin e kaluar.

Përkundër kësaj, unë me kënaqësi mund të konstatoj se sektori i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë ka shënuar një progres në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006. Ky progres, edhe pse modest, është evident pothuajse në të gjithë treguesit e performasës në bazë të cilëve Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) e monitoron dhe e vlerëson punën e kompanive të licencuara që ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, ujërave të zeza, dhe mbeturinave në Kosovë.

Një pjesë e meritave për progresin e arritur duhet padyshim ti atribuohet kontekstit institucional të reformuar të sektorit të shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë që është zhvilluar viteve të fundit (konsolidimi i kompanive në baza regjionale dhe më vonë korporatizimi i tyre, si dhe instalimi i regjimit të rregullativës ekonomike) të cilat reforma pritet të japin efekte edhe më të mëdha në vitet që pasojnë. Sigurisht se një rol të rëndësishëm në arritjen e këtij progresi kanë luajtur edhe komuniteti i donatorëve me investime të konsiderueshme në mbështetjen e kompanive shërbyese sikurse dhe menaxhmenti i këtyre kompanive.

Megjithë progresin e arritur, sektori i shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave në Kosovë ka para vetit shumë sfida për të qenë në gjendje të ofrojë shërbime cilësore dhe efçente për konsumatorët. Absolutisht nuk mund të flitet për shërbime cilësore kur të kihet parasysh fakti se në vitin 2007, shumica e kompanive të ujësjellësit nuk kanë qenë në gjendje të furnizojnë me ujë 24 orë në ditë konsumatorët e vet.

Për përmirësime substanciale dhe në afat të shkurtër është e domosdoshme që të gjitha palët e interesit të veprojnë në mënyrë të harmonizuar dhe të demonstrojnë një përkushtim më të madh dhe qasje strategjike në përmbushjen e përgjegjësive të veta. Kjo para së gjithash ka të bëjë me menaxhmentin e kompanive prej të cilëve ZRRUM pret që në të ardhmen të ekzekutojnë një menaxhim më efikas dhe më efçent dhe të arrijnë rezultate të "prekshme", sidomos në reduktimin e humbjeve të ujit dhe në ngritjen e shkallës së arkëtimin të borxheve, që mbesin dy fushat më problematike në performansën e kompanive të ujit. Edhe pse në të dy këta tregues kompanitë e ujësjellësit kanë arritur një progres (shkalla e arkëtimin është ngritur në 61% nga 57% sa ka qenë në vitin 2006, ndërsa shkalla e humbjeve është zbritur në 58% nga 59% sa ka qenë në vitin 2006) performansa e tyre në këto dy fusha është ende shumë e pafavorshme dhe nuk mundëson gjenerimin e mjeteve të nevojshme për ndërmarrjen e investimeve kapitale të cilat janë të domosdoshme në këtë sektor.

Në këtë plan është inkurajues fakti se në vitet e fundit është ngritur vetdija për rëndësinë e reduktimit të humbjeve të ujit. Një dëshmi për këtë është konferenca vjetore e organizuar në Tetor 2007 nga Asociacioni i Kompanive të Ujësjellësit (SHUKOS-i) që ka pasur temë bosht reduktimin e humbjeve të ujit. Natyrisht se një faktor i rëndësishëm që ka ndikim të drejtëpërdrejtë në performansën e sektorit të shërbimeve të ujit dhe mbeturinave është edhe çështja e sundimit të ligjit në Kosovë. Problemet aktuale të shoqërisë kosovare në sundimin e ligjit reflektohen edhe në punën e kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave para së gjithash me probleme praktike që kanë këto kompani në luftimin kyçjeve ilegale dhe në arkëtimin e borxheve për shërbimet e ofruara. Poashtu edhe pagesa e faturave të ujit për kategorinë e konsumatorëve që nuk kanë mundësi për të paguar (rastet sociale) është një fushë ku është e domosdoshme mbështetja institucionale nga institucionet përkatëse në mënyrë që tu mundësohet kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave operimi në baza të parimeve ekonomike.

ZRRUM do të angazhohet që në bashkëpunim me institucionet përkatëse të ndihmojë në eliminimin e problemeve të kësaj natyre për operimin e kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave.

Në anën tjetër, ZRRUM përmes mekanizmave rregullatore që i ka në dispozicion, do të insitojë para së gjithash ti shtyejë kompanitë që të ngrisin cilësinë dhe besueshmërinë e informacioneve të raportuara që është parakusht për një matje dhe vlerësim objektiv të performansës së tyre. Përmes procesit rregullator ne do të përcaktojmë caqe të cilat kompanitë duhet ti arrijnë sa i përket ngritjes së efikasitetit dhe nivelit të shërbimeve që iu ofrohen konsumatorëve.

Një prej mekanizmave rregullator, që unë konsideroj se i kontribuon ngritjes së performansës së kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave, është nxitja e konkurrencës ndërmjet tyre përmes krahasimit të performansës së tyre. Në këtë kontekst, ky raport, i dyti me radhë që po e publikon ZRRUM, përveq që jep një pasyrë të hollësishme të punës së këtyre kompanive, pretendon të inkurajojë konkurrencën në këto shërbime (të cilat janë shërbime me karakter monopoli) përmes procesit të ashtuquajtur "benchmarking" ose konkurrencës përmes krahasimit. Përkundër disa dobësive që ka metodologjia e vlerësimit të përgjithshëm të performansës (jo të gjitha të dhënat janë plotësisht të besueshme si dhe nuk mirren parasysh faktorët specifik të sistemit që ndikojnë në performansën relative të kompanive) ZRRUM do të vazhdojë me rangimin e kompanive në bazë të treguesve kyç të performansës, meqenëse e konsideron këtë si një nxitje të konkurrencës ndërmjet këtyre kompanive. Në këtë kuadër, në sektorin e shërbimeve të ujësjellësit kompania që është vlerësuar me performansën e përgjithshme më të mirë në vitin 2007 është KRU Radioniqi (Gjakovë), ndërkaq përmirësimin më të madh krahasuar me vitin 2006 e ka demonstruar KRU Hidroregjioni (Prizren).

Në sektorin e grumbullimit të mbeturinave performansën më të mirë në vitin 2007 e ka demonstruar kompania regjionale e mbeturinave KRM "Uniteti (Mitrovicë).

Me qëllim që të ngritet cilësia e këtij raporti në kuptim të saktësisë dhe besueshmërisë së të dhënave të raportuara, sivjet ZRRUM ka bërë për herë të parë auditimin e të dhënave të raportuara nga kompanitë e licencuara. Në këtë kontekst, ZRRUM do të insistojë që kompanitë e licencuara në të ardhmen të avansojnë edhe më tutje saktësinë dhe besueshmërinë e të dhënave të raportuara. Kjo para së gjithash vlen për të dhënat lidhur me sasinë e ujit të prodhuar si dhe për të dhënat që iu referohen shërbimeve ndaj konsumatorëve. Prodhimi i ujit është një e dhënë kyçe që drejtëpërdrejt ndikon në shumë tregues të performansës dhe prandaj është e domosdoshme që kjo e dhënë të bazohet në matje të sakta në pajtim me praktikën dhe teknologjinë e kohës. Është a papranueshme për ZRRUM që kjo e dhënë të raportohet në bazë të vlerësimeve (si në rastin e kompanisë regjionale "Hidroregjioni"). Poashtu, edhe cilësia dhe besueshmëria e të dhënave që kanë të bëjnë me shërbimet ndaj konsumatorëve në përgjithësi nuk është në nivelin e duhur. Sigurisht që saktësia dhe besueshmëria e të dhënave të raportuara është para së gjithash me interes për menaxhmentin e kompanive, por natyrisht se është me interes edhe për procesin rregullator që e zbaton ZRRUM-i. Prandaj, ZRRUM do të angazhohet aktivisht që me mekanizmat ligjor në fuqi, e në bashkëpunim me kompanitë e licencuara, të ngris besueshmërinë e të dhënave të raportuara.

Është me rëndësi fundamentale dhe njëkohësisht orientim strategjik i ZRRUM-it që të vazhdojë të bashkëpunojë ngusht me të gjitha palët e interesit në mënyrë që problemet aktuale në sektorin e ujësjellësit dhe mbeturinave të trajtohen në mënyrë inkluzive dhe të adresohen drejtë. Kjo para së gjithash nënkupton bashkëpunimin me rregullatorët tjerë të sektorit të ujit në Kosovë (MMPH dhe IKSHP) por edhe me akterët tjerë relevant. Poashtu, ZRRUM do të vazhdojë thellimin bashkëpunimit me rregullatorët tjerë ekonomik të ujit në Europë me qëllim të shkëmbimit të përvojave dhe adoptimin e praktikave të mira në zbatimin e rregullativës ekonomike. Tashmë ZRRUM ka krijuar raporte shumë të mira bashkëpunimi me rregullatorin e ujit dhe mbeturinave të Portugalisë (IRAR), me rregullatorin e industrisë së ujit të Skotlandës (WICS), si dhe me Entin Rregullator të Ujit të Shqipërisë (ERRU). Vendet tjera fqinje të regjionit (Maqedonia dhe Mali i Zi) janë në proces të krijimit të autoriteteve rregullatore në sektorin e ujit, dhe ZRRUM në kontaktet që ka pasur me përfaqësuesit e këtyre vendeve ka shprehë gatishmërinë të përcjellë përvojën e vet tek autoritetet pëkatëse të këtyre vendeve.


Në vitin 2007 ZRRUM ka vazhduar të bashkëpunojë ngushtë dhe të konsultohet me kompanitë e ujësjellësit dhe mbeturinave si dhe me palët tjera të interesit lidhur me të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me procesin rregullator. Shtatë punëtori të mbajtura gjatë vitit të kaluar, në të cilat janë trajtuar dhe diskutuar çështje të ndryshme lidhur me sektorët e shërbimeve të ujësjellësit dhe mbeturinave me qëllim të ngritjes së cilësisë së këtyre shërbimeve, janë demonstrim i një qasjeje të hapur dhe inkluzive që e ka ZRRUM në zbatimin e procesit rregullator. Unë dëshiroj të falenderoj me këtë rast kompanitë dhe palët tjera të interesit për pjesëmarrje aktive dhe kontributin e dhënë në këto punëtori dhe takime tjera konsultative që i kemi organizuar.

Dua të theksoj se prej 15 qershorit 2008 ka hyrë në fuqi Ligji i nxjerrë nga Kuvendi i Kosovës (Nr.03/L-086) me të cilin zëvendësohet Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 si bazë ligjore për themelimin dhe përgjegjësitë e ZRRUM-it me çka përgjegjësia e ZRRUM transferohet nga UNMIK/PSSP te Kuvendi i Kosovës në pajtim me shpalljen e pavarësisë dhe hyrjen në fuqi të Kushtetutës së Kosovës. Ligji i ri nuk përmban ndryshime substanciale në krahasim me Rregulloren 2004/49 edhe pse ZRRUM ka propozuar që shërbimet e grumbullimit të mbeturinave të de-rregullohen dhe ti nënshtrohen konkurrencës së tregut Kjo çështje mbetet të diskutohet më tutje dhe eventualisht të përfshihet me ndryshimet e këtij Ligji në të ardhmen.

Në fund dua të shfrytëzoj këtë rast për të falenderuar të gjithë ata që kanë mbështetur dhe po e mbështesin punën e ZRRUM-it. Në veçanti dua të falenderoj Zyrën e Komisionit European për Ndërlidhje (ECLO) si dhe Zyrën Zvicrane për Bashkëpunim (SCO) që përmes konsultantëve të tyre kanë dhënë një kontribut të çmueshëm në hartimin e këtij raporti.

Afrim Lajçi

Drejtor i Zyrës Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina



Parathënie nga Drejtori i Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKSHPK) është përgjegjës për monitorimin e kualitetit të ujit të pijes në pajtim me standardet kombëtare të cilësisë së ujit të pijes në tërë Kosovën. Personeli i IKSHPK grumbullon dhe analizon çdo vit mbi 10.000 mostra të ujit të pijes që furnizohet nga kompanitë publike të licencuara si dhe nga sistemet rurale të ujësjellësit. Ne bëjmë analizat kimike, fizike dhe bakteriologjike dhe në bashkëpunim të ngushtë me kompanitë e ujit dhe me Zyrën Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina (ZRRUM) bëjmë përpjekjet për përmirësimin e cilësisë së ujit të pijes dhe adresojmë çfarëdo problemi që paraqitet.

IKSHPK ka nënshkruar një Memorandum të Bashkëpunimit me ZRRUM në mars të vitit 2007 me qëllim të specifikimit të roleve dhe përgjegjësisë respektive të dy institucioneve tona dhe ne vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me ZRRUM në të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me cilësinë e ujit të pijes që furnizohet nga 7 kompanitë e licencuara regjionale të ujësjellësit.

Ne kemi kënaqësinë që në këtë Raport të Performancës Vjetore, të dytin me radhë që e publikon ZRRUM kualiteti i ujit të pijes në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006 është përmirësuar me faktin që numri i mostrave të cilat nuk i plotësojnë standardet ka rënë për 1 % (pre 4% në 3%). Megjithatë ende ka mjaft hapësirë për reduktimin e numrit të mostrave të cilat nuk i plotësojnë standardet dhe ne do të vazhdojmë të bashkëpunojmë ngushtë me kompanitë e licencuara të ujësjellësit dhe me ZRRUM për adresimin e kësaj çështjeje shumë të rëndësishme në veçanti në rastet kur cilësia bakteriologjike e ujit është joadekuate.

IKSHPK ka kënaqësinë që të kontribuojë në Raportin Vjetor të Performancës lidhur me shërbimet e ofruara nga kompanitë e ujësjellësit dhe mbeturinave duke pasur parasysh se kualiteti i ujit të pijes është element kyç i shërbimeve të ujësjellësit.

Në veçanti ne jemi të angazhuar që në të ardhmen e afërt të nxjerren dhe aplikohen standardet e reja dhe regjimi i ri i mostrimit për kualitetin e ujit të pijes në pajtim me Direktivën Europiane 98/83/EC.

Prof. Dr. Assoc. Naser Ramadani

Drejtor Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike

Shkurtesat

AKKM	●	Agjencioni Kosovar për Mbrojtjen e Mjedisit
AKM	●	Agjencia Kosovare e Mirëbesimit
KfW	●	Kreditanstalt für Wiederaufbau
TKP	●	Tretuesit Kyç të Performancës
IKSHPK	●	Instituti Kombëtar për Shëndetin Publik në Kosovë
MMPH	●	Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
NP	●	Ndërmarrjet Publike
NSH	●	Ndërmarrjet Shoqërore
OFCR	●	Raportimi Operativ, Financiar dhe për Konsumatorë
OFMP	●	Projekti për Monitorimin Operativ dhe Financiar
PSSP	●	Përfaqësuesi Special i Sekretarit të Përgjithshëm
SHUKOS	●	Shoqata e Ujësjetësve dhe Kanalizimeve në Kosovë
UPF	●	Uji i Pa-Faturuar
UNMIK	●	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
ZRRUM	●	Zyra Rregullatore për Ujë dhe Mbeturina

● Qëllimi i Raportit Vjetor të Performansës

Ky është raporti i dytë vjetor të cilin e publikon ZRRUM-i për performansën e kompanive publike të cilat ofrojnë shërbimet e ujësjellësit, ujërave të zeza dhe shërbimet e mbeturinave (grumbullimi dhe deponimi) në Kosovë.

Qëllimi i këtij raporti është që të ngritet transparencja dhe llogaridhënia lidhur me shërbimet e ujësjellësit, ujërave të zeza dhe mbeturinave në Kosovë përmes dhënies së një pasqyre të plotë dhe objektive për performansën financiare, operative, dhe të nivelit të shërbimeve që kanë pasur në vitin 2007 kompanitë publike që ofrojnë këto shërbime. Poashtu raporti ka për qëllim që të krahasojë performansën e kompanive të ujësjellësit dhe mbeturinave në vitin 2007 me atë të vitit 2006 si dhe të krahasojë performansën relative të secilës kompani me kompanitë tjera të ngjajshme në Kosovë.

Ky raport iu ofron të gjitha palëve të interesit, përfshirë konsumatorët, mundësinë që të shohin se çfarë kanë qenë treguesit e punës dhe niveli i shërbimeve të ofruara nga kompanitë e ujësjellësit dhe kompanitë e mbeturinave. Përpos kësaj, raporti është në funksion të nxitjes së konkurrencës dhe ka për qëllim final ngritjen

● Besueshmëria e të Dhënave të Raportuara

Të dhënat që janë shfrytëzuar në këtë raport janë raportuar nga kompanitë e licencuara të ujësjellësit dhe mbeturinave në pajtim me obligimet e tyre raportuese që janë përcaktuar me ligj dhe me licencat e tyre të shërbimit. Me qëllim të ngritjes së nivelit të saktësisë dhe besueshmërisë së këtij raporti, të dhënat eraportuara nga kompanitë i janë nështruar auditimit nga ana e ZRRUM-it që është zhvilluar për herë të parë sivjet.

Të gjitha kompanitë e licencuara janë vizituar nga ekipi auditues i ZRRUM-it në muajin prill 2008. Ky auditim ka konsistuar në krahasimin e të dhënave të raportuara nga kompanitë me të dhënat reale të cilat janë konstatuar në sistemin informativ të secilës kompani. Përveç kësaj, të gjitha të dhënat e shfrytëzuara në këtë raport janë vlerësuar nga kompanitë para se raporti të finalizohet, prandaj ZRRUM konsideron se këto të dhëna janë korrekte dhe të drejta.

● Analizimi i të Dhënave të Raportuara dhe Vlerësimi i Performansës

Të dhënat e raportuara janë analizuar në bazë të treguesve të përzgjedhur të performansës. Për secilin tregues të performansës është dhënë pasqyra e vlerave të secilës kompani veq e veq si dhe mesatarja e sektorit.

Ndërkaq vlerësimi i përgjithshëm i performansës së kompanive dhe rangimi i tyre është bërë në bazë të një numri të kufizuar të treguesve kyq të performansës (TKP) të cilët janë vlerësuar nga ZRRUM të jenë: (i) më të besueshëm, (ii) më relevant, dhe (iii) nën kontrollin e menaxhmentit të kompanive.

● **Kompanitë e Licencuara**

Në këtë raport është përdorur termi “kompanitë e licencuara” me të cilin term përfshihen 16 kompanitë publike të cilat janë nën mandatin rregullator të ZRRUM-it në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49, dhe të cilat kompani që ofrojnë shërbimet e: (i) ujësjellësit dhe ujërave të zeza (7), (ii) ujit me shumicë (1), grumbullimit të mbeturinave (7), dhe deponimit të mbeturinave (1).

Në raste të caktuara përdoren edhe termat: kompanitë e ujësjellësit dhe ujërave të zeza, ose kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, ose kompania e furnizimit të ujit me shumicë, ose kompania për menaxhimin e mbeturinave, për të përcaktuar më saktësisht veprimtarinë specifike të tyre. Detajet e kontaktimit të këtyre kompanive janë dhënë në Shtojcën E.

● **Struktura e Raportit**

Ky raport përbëhet prej pesë kapitujve:

Kapitulli 1 trajton cilësinë e të dhënave të shfrytëzuara në këtë raport në kuptim të saktësisë dhe besueshmërisë së tyre. Në këtë kapitull jipen konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me përmirësimin e cilësisë së të dhënave të raportuara që është me rëndësi esenciale për një vlerësim dhe krahasim të mirëfilltë të performancës së kompanive.

Kapitulli 2 ofron një pasqyrë të performancës së sektorit të shërbimeve të ujësjellësit dhe ujërave të zeza dhe vlerëson performancën relative të secilës prej shtatë kompanive krahasuar me kompanitë tjera për vitin 2007 si dhe krahasur me performancën e vet në vitin 2006. Në fund të këtij kapitulli është bërë rangimi i kompanive sipas performancës së matur në bazë të treguesve kyq të performancës (TKP).

Kapitulli 3 ofron një pasqyrë të performancës së shtatë kompanive regjionale të grumbullimit të mbeturinave në formën e njëjtë sikurse në rastin e kompanive të ujësjellësit dhe ujërave të zeza;

Kapitulli 4 jep një pasqyrë të performancës së Kompanisë për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KLMC) e cila është kompani e vetme që menaxhon deponitë sanitare të mbeturinave në Kosovë; dhe

Kapitulli 5 jep një përmbledhje të shkurtër të performancës së ofruesit të vetëm të shërbimeve të furnizimit të ujit me shumicë në Kosovë, kompanisë Ibër-Lepenci.

Përpos kësaj raporti përmban edhe gjashtë shtojca:

Në Shtojcën A janë dhënë definicionet për treguesit e performancës të shfrytëzuar në këtë raport;

Në Shtojcën B janë dhënë sqarime lidhur me vlerësimin e përgjithshëm të performancës (treguesit kyq të selektuar, metodologjia e përdorur, arësyet etj.)

Në Shtojcën C janë dhënë të dhënat kryesore statistikore për parametrat operativ, financiar, dhe të shërbimeve të konsumatorëve për kompanitë e licencuara;

Në shtojcën E është dhënë një abstrakt nga Rregullorja 2004/49 që përcakton standardet e shërbimit të aplikueshme për shërbimet e ujësjellësit, ujërave të zeza, grumbullimit të mbeturinave, si dhe deponimit të mbeturinave; dhe

Në shtojcën E janë dhënë detajet e kontaktimit të kompanive të licencuara, ZRRUM-it, dhe të Komisioneve regjional Këshilluese të Konsumatorëve.

Në shtojcën F janë paraqitur në formë të hartave zonat e shërbimit të kompanive regjionale të ujësjellësit dhe atyre të grumbullimit të mbeturinave; dhe

Në fund të raportit është dhënë një përmbledhje e shkurtër e rolit dhe përgjegjësisë të ZRRUM-it.

Kapitulli 1

Cilësia e Informacioneve - Auditimi i të Dhënave

Për një vlerësim të duhur të performancës së kompanive dhe për realizimin e një krahasimi të arësyeshem nga ky vlerësim, është me rëndësi esenciale që të dhënat e shfrytëzuara të jenë të besueshme dhe kuptimplote. Prandaj, me qëllim të dhënies së një pasqyre të plotë dhe reale të performancës së kompanive përmes këtij Raporti Vjetor të Performancës, ZRRUM këtë vit, për herë të parë, ka bërë auditimin/inspektimin e të dhënave operative, financiare dhe ato lidhur me shërbimet ndaj konsumatorëve të raportuara gjatë 2007 në ZRRUM nga kompanitë e ujit dhe mbeturinave.

Procesi i auditimit, që është realizuar nga stafi i ZRRUM në Prill 2008, ka përfshirë: (i) kontrollimin e besueshmërisë së të dhënave të raportuara dhe (ii) kontrollimin nëse kompanitë e licensuara i kanë zhvilluar dhe i përdorin procedurat të kërkuara nga Rregullorja e ZRRUM. Ky proces tani e tutje do të jetë aktivitet i rregulltë vjetor. Përveç kësaj, ZRRUM do të bëjë edhe inspektim/auditim "ad-hock" të të dhënave relevante lidhur me çështjet specifike kurdo që konsideron se është e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë të veta rregullatore.

ZRRUM-i vlerëson se auditimi si proces është pranuar mirë dhe përkrahur nga të gjitha kompanitë. Prandaj, ZRRUM iu shpreh mirënjohje të gjitha kompanive për nivelin e lartë të bashkëpunimit të ofruar gjatë tërë procesit të auditimit të të dhënave.

Pas auditimit fizik të të dhënave, ZRRUM ka përgatitur Raportet e Auditimit për secilën kompani. Këto raporte i janë nënshtruar shqyrtimit dhe komentimit nga të gjitha kompanitë para finalizimit të tyre.

● Konkluzionet e përgjithshme

Sektori i ujit

Ekipi i auditimit, në bazë të të gjeturave, vlerëson se vërejtjet kryesore bien në mos përdorimin e plotë dhe të duhur të moduleve të sistemit informativ të të dy pakove softuerike që i kanë në dispozicion kompanitë e ujit (Pro-net dhe Piano), si dhe mungesës së aplikacioneve tjera që do të duhej të ishin pjesë e këtyre pakove softuerike.

Asnjë nga të shtatë kompanitë regjionale të ujit nuk kanë sistem të duhur të menaxhimit të të dhënave të relacioneve me konsumatorë.

Sa i përket të dhënave të ujit të prodhuar, në shumicën e kompanive kjo e dhënë bazohet në leximin e ujëmatësve të instaluar në dalje të impiantit të trajtimit të ujit ndërsa ende ka raste kur kjo e dhënë është e vlerësuar d.m.th. nuk është e matur me ujëmatës. Aty ku të dhënat janë të vlerësuara e jo të matura, paraqitet shqetësim serioz në lidhje me saktësinë e disa treguesve të performancës (veçanërisht të atyre të ujit të pafaturuar) të shtjelluar në pjesët tjera të këtij raporti.

Nga të gjeturat vlerësohet se disa nga të dhënat teknike që kanë të bëjnë me shërbimin e kanalizimit, nuk janë regjistruar në aplikacionet përkatëse të sistemit gjithëpërfshirës të menaxhimit të informacioneve të kompanive.

Në përgjithësi, kompanitë (përveç KRU 'Radoniqi', SH.A.) nuk i kanë në formë të shkruar disa prej procedurave të nevojshme për menaxhimin efikas të çështjeve me rëndësi për procesin rregullator.

Sektori i grumbullimi të mbeturinave

Ekipi i auditimit, në bazë të të gjeturave, vlerëson se vërejtjet kryesore bien në mos funksionimin si duhet të moduleve të sistemeve informative ekzistuese.

Vlerësojmë si të tepërt shtjellimin më detaj të mos funksionimit të këtyre moduleve pasi që i tërë Sistemi Informatik Menaxhues (SIM) i tanishëm do të zëvendësohet me një paketë të re të SIM, e cila do të përfshijë të gjitha modulet e mundshme të nevojshme për menaxhimin e informatave në të gjitha kompanitë e grumbullimit të mbeturinave.

Është vlerësuar se asnjë nga kompanitë nuk kanë në formë të shkruar disa prej procedurave të nevojshme për menaxhimin efikas të çështjeve me rëndësi për procesin rregullator.

Sektori i deponimit të mbeturinave

Ekipi i auditimit, në bazë të të gjeturave, vlerëson se sistemi i mbajtjes së të dhënave është në nivelin e kënaqshëm.

Vërejtjet për mos pajtueshmërinë e të dhënave financiare të raportuara, kryesisht bien në kuptimin jo të drejtë të definicioneve të të dhënave.

● Rekomandimet e përgjithshme

Sektori i ujit

Për të siguruar një menaxhim më të mirë të të dhënave nëpër kompani, të cilat rezultojnë me raportim të të dhënave të sakta në ZRRUM, ekipi i auditimit rekomandon kompanitë:

- që edhe më tutje të zhvillojnë modulet e sistemit informativ 'Pro.net' dhe 'Piano'
- të sigurojnë trajnim adekuat të stafit nga ana e furnizuesve të softuerit në rast të aplikimit të moduleve të reja (p.sh. moduli i relacioneve me konsumatorë) së bashku me mbështetjen adekuate softuerike dhe përmirësimin e marrëveshjeve për funksionimin e tërë paketës softuerike.
- të zhvillojnë modulin e relacioneve me konsumatorë
- të përdatësojnë sistemin informativ gjeografik (GIS) me të dhënat e shërbimit të ujës-jellësit dhe kanalizimit
- të zhvillojnë sistem më të sofistikuar të ruajtjes në mënyrë elektronike të të dhënave të prodhimit të ujit
- instalojnë ujëmatësit në dalje të çdo impianti të ujit, gjë që mënjanon raportimin e sasisë së vlerësuar të ujit të prodhuar
- të definojnë qartë zonat të cilat i nënshtrohen reduktimeve të ujit dhe të caktojnë numrin e konsumatorëve në këto zona
- të përpilojnë dhe zbatojnë procedurat interne për menaxhimin e grumbullimit dhe raportimit të të dhënave

Sektori i grumbullimit të mbeturinave

Për të siguruar një menaxhim më të mirë të të dhënave nëpër kompani dhe rrjedhimisht një raportim të të dhënave të sakta në ZRRUM, ekipi i auditimit rekomandon kompanitë:

- që të dhënat e raportuara ti bazojnë në shënimet e mbajtura dhe të ruajtura në mënyrë të rregulltë
- të i kushtojnë kujdes regjistrimit të të gjitha të dhënave nëpër modulet relevante të paketës së re të SIM-it, ashtu që të bëjnë të mundur ekstraktimin e lehtë të informatave nga raportet përkatëse
- të sigurojnë trajnim adekuat të stafit nga ana e furnizuesve të softuerit për modulet e reja të paketës së SIM që do të bënte të mundshme nxjerrjen e lehtë të të dhënave prej raporteve
- të përpilojnë dhe zbatojnë procedurat interne

Sektori i deponimit të mbeturinave

Me qëllim të përmirësimit të raportimit të performancës, ekipi i auditimit rekomandon që të dhënat e raportuara të jenë plotësisht në linjë me kërkesat raportuese të ZRRUM.

Kapitulli 2

Performanca e Sektorit të Ujit

Monitorimi i Performancës Operative, Financiare dhe Shërbimit me Konsumatorë

Para themelimit të ZRRUM (në nëntor 2004), monitorimi i performancës së kompanive të ujësjellësit dhe kanalizimit është zhvilluar në kuadër të Projektit për Monitorim Financiar dhe Operativ (OFMP). Qëllimi i tij ishte të krijojë, zbatojë dhe të zhvillojë më tutje një sistem të kompjuterizuar për monitorimin e raportimit dhe publikimin e të dhënave mbi performancën operative dhe financiare të shtatë kompanive regjional të ujësjellësve në Kosovë.

Ky projekt, në fund të vitit 2006 u transferua nga AKM te ZRRUM, pasi që monitorimi dhe vlerësimi i performancës është aktivitet tipik ekonomik rregullator, prandaj ZRRUM u pa si institucioni më adekuat për menaxhimin e kësaj përgjegjësie të rëndësishme rregullatore. Në vitin 2007 ZRRUM ka zgjeruar sistemin e raportimit (OFCR) me më shumë kërkesa të dhënave teknike dhe shërbimit me konsumatorë në konsultim me kompanitë e ujit (dhe mbeturinave).

Duke e pasur parasysh rëndësinë e monitorimit dhe raportimit të performancës dhe me qëllim të ngritjes së cilësisë së këtij aktiviteti në fillim të vitit 2008 ZRRUM i është siguruar asistencë teknike përmes konsulentit lokal të financuar nga SDC përmes projektit të financimit WM - OFMP.

● Standardet e Performancës

Shërbimet e ujësjellësit

Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 (Neni 11(a)), (në tekstin e mëtutjeshëm "Rregullorja") parasheh standardet e mëposhtme për ofrimin e shërbimeve të furnizimit me ujë për:

- Cilësinë e ujit
- Presionin e ujit
- Furnizimin e vazhdueshëm
- Numrin e ndërprerjeve
- Kohën e nevojshme për hetimin dhe riparimin e rrjedhjeve
- Kohën për shqyrtimin e aplikacioneve për shërbime të ujit

**Këto të dhëna për 2006/2007që kanë të bëjnë me presionin e ujit nuk janë raportuar nga kompanitë e ujit në ZRRUM.*

Standardet e caktuara, siç janë përcaktuar në Rregullore janë dhënë në Shtojcën D. Katër nga këto standarde nuk janë shqyrtuar më poshtë në këtë raport.

Shtypja në rrjet, është shumë vështirë të matet dhe të raportohet nga kompanitë për shkak të arsyeve të ndryshme teknike, p.sh. topografisë, dhe pengesave tjera teknike. Për këtë arsye nga kompanitë nuk është kërkuar ende të masin dhe raportojnë për këtë standard të shërbimit.

Numri i ndërprerjeve aktualisht raportohet nga kompanitë. Megjithatë, furnizimi i vazhdueshëm (pa ndërprerë) siç është paraqitur në seksionin paraprak, konsiderohet të jetë tregues më i arsyeshëm për shërbimet e ofruara.

Koha e përgjigjeve ndaj kërkesave të konsumatorëve ka filluar të raportohet nga kompanitë në ZRRUM, mirëpo ky standard nuk është shqyrtuar në këtë raport për shkak të vënies në pikëpyetje të besueshmërisë së të dhënave të raportuara.

Koha për shqyrtimin e ankesave është raportuar nga kompanitë në ZRRUM gjatë vitit 2007, ndërsa në këtë raport janë marrur parasysh vetëm të dhënat e besueshme të ofruara nga kompanitë. ZRRUM vlerëson se kompanitë duhet të zhvillojnë një sistem më të mirë të menaxhimit të relacioneve me konsumatorë, sistem ky që rrjedhimisht do të rezultojë në përmirësime të dukshme në trajtimin dhe raportimin e të dhënave të besueshme mbi të cilat ZRRUM-it do të vlerësoj dhe raportojë performancën në mënyrë të saktë.

Shërbimet e kanalizimit

Rregullorja (Neni 11 (b)) parasheh këto standarde për ofrimin e shërbimeve të kanalizimit:

- Frekuenca e pastrimit të kanalizimit
- Frekuenca dhe koha për riparimin e rrjedhjeve dhe përmytjes në kolektorët e kanalizimit
- Koha për shqyrtimin e kërkesave për shërbimet e kanalizimit

Performanca e kompanive kundrejt këtyre standardeve, fatkeqësisht nuk është konsideruar në këtë raport për shkak se të dhënat mbi performancën të raportuara nga kompanitë nuk janë konsideruar si mjaft të besueshme.

Standardet që merren parasysh në përcaktimin e tarifave

Neni 10.3 i Rregullores përfshinë kërkesën që procesi i përcaktimit të tarifave nga ZRRUM do të merr parasysh shkallën deri në të cilën kompanitë, gjatë 12 muajve të fundit, kanë:

- Ofruar shërbimet në përputhje me standardet e aplikueshme të shërbimit
- Përmbytur standardet relevante mjedisore të aplikueshme në Kosovë
- Zbritur sasinë e UPF
- Rritur numrin total të faturave të dërguara te konsumatorët dhe përqindjen e të gjitha faturave të arkëtuara

Mund të konkludohet nga kjo kërkesë e Rregullorës që ku indikator i caktuar i performancës është më rëndësishëm nga të tjerët për vlerësimin e performancës së kompanive të ujit dhe prandaj do të shqyrtohet më vonë këtë raport.

● Treguesit e Përdorur në këtë Raport

Standardet teknike dhe shërbimit me konsumatorë

Zgjedhja e çdo treguesi të performancës për sektorin e ujësjellësit të shqyrtuar në këtë raport është përcaktuar kryesisht nga informatat e pranuar nga kompanitë duke marrë parasysh standardet relevante të specifikuar në Rregullore.

Treguesit shtesë të përdorur në këtë pjesë të raportit, por që nuk janë të kërkuar në mënyrë të posaçme me këtë Rregullore, janë zgjedhur për të dhënë një pasqyrë më reale të nivelit të shërbimeve të ofruara nga kompanitë. Lista nuk është gjithëpërfshirëse dhe është limituar në shtatë tregues teknik/shërbim të konsumatorëve.

Treguesit e përdorur teknik dhe shërbimit me konsumatorë janë:

- Kualiteti i ujit
- Disponueshmëria e ujit
- Shtrirja e shërbimeve (ujë dhe kanalizim)
- Konsumi i matur me ujëmatës
- Efikasiteti i stafit
- UPF (në përqindje)
- UPF (në litra për konsumator në ditë)
- Nr. i ankesave për 1000 konsumatorë

Treguesit financiar

Katër treguesit kryesor financiar të përdorur në këtë raport janë:

- Norma e punës
- Norma e mbulesës së punës
- Shkalla e arkëtimit
- Kostoja e prodhimit për njësi

Disa nga treguesit e lartpërmendur të performancës ndikojnë në një ose më shumë tregues të tjerë të performancës (për shembull reduktimi i presionit mund të rezultojë në reduktimin e humbjeve fizike të ujit) dhe rrjedhimisht fokusimi në rezultatet e dhëna të vetëm një treguesi mund të jetë çorientues.

Në këtë raport secili tregues është shqyrtuar veçmas për qëllime të thjeshtësisë por vlerësimi i përgjithshëm është bërë për të dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të performancës së kompanisë.

● Kualiteti i ujit

Kualitetit i ujit të pijes që u ofrohet konsumatorëve nga kompanitë e ujësjellësit është një prej standardeve kryesore që duhet ti plotësojnë këto kompani pasi që ka ndikim të drejtpërdrejtë në shëndetin publik. Kjo është e përcaktuar me Rregulloren 2004/49 dhe prandaj ZRRUM ka përgjegjësi ligjore të sigurojë se uji të cilin e furnizojnë kompanitë e licencuara të ujësjellësit duhet të jetë në pajtim me standardet të kualitetit të ujit të pijshëm në fuqi në Kosovë.

Në anën tjetër, autoritet përgjegjës për përcaktimin e standardeve të kualitetit të ujit të pijes është IKSHPK i cili gjithashtu monitoron përmbushjen e këtyre standardeve përmes marrjes dhe analizimit të mostrave në pajtim me aktet ligjore në fuqi.

Në pajtim me përgjegjësitë që kanë lidhur me kualitetin e ujit të pijes, ZRRUM dhe IKSHPK kanë nënshkruar një Memorandum të Mirëkuptimit në Mars 2007 për bashkëpunim të mëtijshëm në mënyrë që të sigurohet se uji i cili u ofrohet konsumatorëve nga kompanitë e ujësjellësit të jetë konform standardeve të përcaktuara dhe rolet e përgjegjësitë e IKSHPK dhe ZRRUM-it të definohen në mënyrë të qartë.

Përveç kësaj, ZRRUM-i ka intensifikuar aktivitetin e vet me qëllim të ngritjes së kualitetit të ujit të pijes dhe në këtë drejtim është duke u angazhuar për avansimin e standardeve për cilësinë e ujit në Kosovë, në përputhje me Direktivën e fundit të BE (98/83/EC) për Cilësinë e Ujit të Pijshëm.

¹Udhëzimi Administrativ (Shëndeti) 2/1999. Ky standard ka nevojë për ndryshime urgjente me qëllim që të jetë në përputhshmëri me standardet aktuale për mostrimin dhe analizat e kualitetit të ujit të pijshëm në pajtim me Direktivën Europiane 98/83/EC.

Figura 1 paraqet përqindjen e testeve të kualitetit të ujit që nuk i kanë plotësuar standardet bakteriologjike, fizike dhe kimike të kualitetit të ujit të pijshëm në 2006 dhe 2007 për secilën kompani.

Përderisa nuk është bërë dallimi i karakteristikave të ndryshme në Figurë, shumica e testeve të kryera (dhe atyre që nuk janë në pajtim me standardet) lidhen me parametrat mikrobiologjik.




Figura 1 Kualiteti i ujit

Në 2007 krahasuar me 2006 katër prej shtatë kompanive të ujësjellësit kanë treguar përmirësim sa i përket të kualitetit të ujit, ndërkaj të kompanitë 'Prishtina', 'Hidromorava' dhe 'Bifurkacioni' ka përqendrim të performancës krahasuar me 2006.

ZRRUM vlerëson se në këtë fenomen mund të kenë ndikuar sidomos ndërprerjet e shpeshta të ujit (reduktimet e theksuara) për shkak të thatësisë gjatë vitit 2007, duke llogaritur se rrjeti shpërndarës i ujit në Kosovë kryesisht është në gjendje jo të mirë dhe kontaminimi i ujit mund të vij si rezultat i ndërprerjeve.

Përmirësimi i dukshëm i kualitetit të ujit në Hidrodrin ka ardhë si rezultat i instalimit të sistemeve më mira të klorizimit në njësitë operative të Klinës dhe Junikut.

Në përgjithësi, performanca e sektorit sa i përket kualitetit të ujit është përmirësuar duke shënuar rënie të shkallës së mospërmbushjes së standardeve të kualitetit të ujit nga 4.1% në 2006 në 3.2% në 2007. Radoniqi kryeson me kualitetin më të mirë të ujit të furnizuar kundrejt gjashtë kompanive tjera të ujësjellësit.

Megjithatë, ZRRUM-i konsideron që pavarësisht nga rrethanat specifike në 2007, të gjitha kompanitë duhet të përpiqen që të përmirësojnë kualitetin e ujit të pijshëm në të ardhmën, sidomos kualitetin mikrobiologjik. Me rëndësi të veçantë është që numri i mostrave të marra duhet të jenë në përputhje me kërkesat minimale të përcaktuara nga IKSHPK dhe klorizimi i ujit të trajtuar duhet të jetë efektiv gjatë gjithë kohës.

● Kontinuiteti i Furnizimit me Ujë

Furnizimi i vazhdueshëm me ujë raportohet nga kompanitë në formë të orëve të furnizimit, d.m.th. mesatarja e numrit të orëve në ditë që konsumatorët furnizohen me ujë në zonë të shërbimit.

Figura 2 tregon mesataren e orëve në ditë që konsumatorët furnizohen me ujë. Gjatë përlogaritjes së këtij treguesi janë marrur në konsiderim vetëm orët e furnizimit me ujë ndërsa shtypja nuk është përfshirë. Të dhënat e shtypjes së ujit nuk janë grumbulluar meqë kompanitë nuk disponojnë me paisjet matëse adekuate dhe çfarëdo rezultate do të ishin të pasakta dhe çorientuese.




Figura 2 Kontinuiteti i furnizimit me ujë

Në 2007, Hidrodrini, Radoniqi, dhe Hidroregjioni Jugor kanë vazhduar furnizimin e konsumatorëve të tyre me ujë pa ndërprerje 24 orë në ditë, përkundër disa ndërprerjeve të vogla si pasojë e thatësisë ekstreme që ka mbretëruar këtë vit. Zona e shërbimit të kompanisë Ujësjellësi Regjional, Mitrovicë, me 18 orë, është mbrapa standardit për shërbim si rezultat i kapacitetit të limituar të impiantit. Ndërkaq tri kompanitë tjera të ujësjellësit (Prishtina, Hidromorava, Bifurkacioni) nuk kanë siguruar të dhëna të besueshme mbi furnizimin e vazhdueshëm të ujit. ZRRUM është në dijeni që këto kompani nuk kanë qenë në gjendje të plotësojnë standardin për furnizim me ujë 24 orë në ditë për shkak të kufizimeve sa i përket kapaciteteve prodhuese dhe pengesave në burime.

Përlogaritja e mesatares në nivel të sektorit prej 23 orëve të furnizimit me ujë bazohet në të dhënat e katër kompanive të ujit (Hidrodrini, Hidroregjioni Jugor, Radoniqi dhe Ujësjellësi Regjional, Mitrovicë). Kjo për faktin se të dhënat e raportuara nga Prishtina, Hidromorava dhe Bifurkacioni janë vlerësuar nga ZRRUM si të pabesueshme.

Nëse kompanitë nuk janë në gjendje të furnizojnë konsumatorët e tyre me ujë për 24 orë çdo ditë, atëherë nga ato kërkohet që në pajtim me Rregulloren të aplikojnë në ZRRUM për lirim të tyre nga përmbushja e standardeve dhe me një marrëveshje formale me ZRRUM të përfshihen aranzhimet për shpërndarjen në mënyrë të drejtë dhe pa diskriminime të resurseve në dispozicion të ujit. ZRRUM do të përpiqet të sigurojë që këto kompani të aplikojnë për lirim nga përmbushja e standardeve kur është nevoja dhe që procesi formal të zbatohet në 2008.

● **Shtrirja e Shërbimeve të Ujësjesit dhe Kanalizimit**

Figura 3 paraqet përqindjen e popullatës brenda çdo zone të përkufizuar të ofrimit të shërbimeve nga kompania përkatëse, me qasje në shërbimet publike të ujit.




Figura 3 Shtrirja e shërbimeve me ujë

Bazuar në të dhënat e raportuara nga kompanitë e ujit në 2007, në shifra absolute, popullsia që jeton në tërë zonën ku veprojnë të shtatë kompanitë regjionale të ujësjesit është 2,374,230, prej të cilëve vetëm 1,698,560 (71%) kanë qasje në shërbimet e ujësjesit të ofruara nga këto kompani.

Të dhënat për të dy vitet (2006 dhe 2007) janë të dhëna të vetme të vlerësuara, prandaj ZRRUM e konsideron si të padobishme që të komentoj ndryshimin e të dhënave prej vitit në vit.

Sipas të dhënave, Hidromorava ka shkallën më të lartë të shtrirjes së shërbimeve me 88% përderisa Bifurkacioni më të ultën me përafërsisht 45%. Megjithatë, ZRRUM konsideron që të dhënat e raportuara paraqesin vlerësimin arbitrar dhe rrjedhimisht nuk ofrojnë të dhëna të sigurta lidhur me shtrirjen e shërbimeve të ujit.

Tani për tani në Kosovë nuk ka politika ose synime zyrtare për shtrirje të shërbimeve ndaj të cilave ZRRUM do mund të monitorojë ose raportojë progresin, edhe pse ZRRUM në parim pret mbulim të 100% me shërbime (përveç atyre që nuk dëshirojnë të furnizohen) në një të ardhme të afërt.

Figura 4 paraqet përqindjen e popullatës brenda çdo zone të përkufizuar të ofrimit të shërbimeve nga kompania përkatëse, me qasje në shërbimet e kanalizimit.



Figura 4 Shtrirja e shërbimeve të kanalizimit

Sa i përket mbulimit me shërbime të kanalizimit, prej tërë popullsisë së përfshirë në zonën e gjashtë kompanive të ujësjellësit vetëm 62% kanë qasje në këtë shërbim të ofruar nga këto kompani. Hidromorava nuk e ka raportuar këtë të dhënë.

Në vitin 2007, sipas të dhënave në dispozicion të cilat janë të vlerësuara nga vetë kompanitë, Ujesjellesi Regjional, Mitrovicë ka pasur shkallën më të lartë të shtrirjes së shërbimeve të kanalizimit me 64% përderisa Hidrodrini më të ultën me përafërsisht 23%.

Në përgjithësi ZRRUM konsideron se si rezultat i shkallës së ulët të mbulimit me shërbime të ujësjellësit dhe kanalizimit ekziston nevoja për investime në zgjerimin dhe rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësit dhe kanalizimit dhe paralel me këtë edhe shtimin e kapaciteteve të prodhimit të ujit si dhe ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të zeza.

● Konsumi i Matur

Konsumi i matur si tregues paraqet përqindjen e konsumuar bazuar në leximin faktik të ujëmatësve në krahasim me sasinë totale të ujit të faturuar (konsumimi i matur plus paushall)².

Matja e konsumit konsiderohet si një praktikë e mirë për të dy palët, si për kompaninë poashtu edhe për konsumatorin. Përveç se është metoda më e drejtë e faturimit për shërbimin e ofruar, ajo iu mundëson konsumatorëve që të menaxhojnë konsumin e tyre të ujit, ndërsa kompanisë i mundëson njohjen e sasisë reale të ujit të faturuar. Për kundër kësaj, konsumimi paushall pasqyron mesataren e supozuar, dhe nëse nuk llogaritet siç duhet nga kompanitë e ujit mund të siguroj informata të gabuara për treguesit e tjerë, sidomos për ujin e pafaturuar.




Figura 5 Konsumi i matur

Nga Figura 5 vërehet se katër nga shtatë kompanitë e ujësjellësit kanë treguar trende pozitive të zhvillimit të këtij treguesi. Kjo ka ardhur si rezultat i rritjes së numrit të konsumatorëve me ujëmatësit, ndërsa në mesatare konsumimi i ujit (në bazë të dhënave të faturimit) nga konsumatorët me ujëmatësit është zvogëluar.

Përderisa Radoniqi ka plotësuar kuotën më të lartë të këtij treguesi, Bifurkacioni dhe Ujësjellësi Regjional, Mitrovicë ende faturojnë bazuar në matje vetëm 63% respektivisht 65% të sasisë totale të ujit të faturuar.

Në përgjithësi, matja e konsumimit është zvogëluar nga 83% në 2006 në 81% në 2007. ZRRUM vlerëson se ndryshimi negativ mund të jetë rezultat i raportimit më të saktë të të dhënave në 2007 krahasuar me 2006.

²Totali i vëllimit të ujit të faturuar përmban vëllimin e ujit të matur përmes ujëmatësve funksional plus vëllimin e ujit paushall që vlerësohet të jetë konsumuar për konsumatorët që nuk kanë ujëmatës ose që nuk iu punojnë ata.

● Efikasiteti i Stafit

Figura 6 tregon efikasitetin e stafit për çdo kompani, llogaritur si numër i stafit të punësuar për 1000 konsumatorë. Ky tregues ofron informata se si kompania shfrytëzon resurset e veta njerëzore. Është e kuptueshme se shifrat më të ulta janë tregues i operimit më efikas të kompanive dhe rrjedhimisht janë më të dëshirueshme.

Pasi që kostoja e stafit është një nga kostot më të rëndësishme të kostos operative për secilën kompani, ky tregues është pasqyrim i rëndësishëm i eficiencës së përgjithshme të kompanisë.




Figura 6 Efikasiteti i stafit

Rezultatet e bazuara në të dhënat e 2007 tregojnë se numri mesatar i stafit për 1000 konsumatorë (pika faturuese) është 7.32 që paraqet një përmirësim krahasuar me 2006 kur ky tregues ishte 7.57. Rritja e efikasitetit të stafit prej vitit në vit për sektorin është realizuar përmes një rritje të konsiderueshme të numrit të konsumatorëve.

Kompania më e mirë në këtë tregues mbetet Hidroregjioni Jugor me 5.93 ndërsa më e dobëta Ujesjellësi Regjional, Mitrovicë me 11.03. Efikasiteti i ulët i stafit në Ujesjellësin Regjional, Mitrovicë është për shkak të llogaritjes së tërë pjesës veriore të Mitrovicës si vetëm një pikë faturuese (si konsumatorë i ujit me shumicë).

Edhe përkundër përmirësimit të këtij treguesi në 2007 krahasuar me 2006, ZRRUM ende konsideron se ky tregues paraqet staf të tepërt në kompanitë e ujit krahasuar me vendet e tjera evropiane ku nivelet e zakonshme e efikasitetit të stafit janë 4-6.

Në kompanitë me shtrirje të ulët të shërbimeve mund të arrihen përmirësime të dukshme në efikasitet përmes zgjerimit të shërbimeve me më pak ngritje të numrit të stafit.

Në 2007 krahasuar me 2006 niveli më i ulët i efikasitetit të stafit në Hidromoravë dhe Bifurkacion ka ardhur si rezultat i përmirësimit të bazës së të dhënave të konsumatorëve që rezulton në rritjen e numrit të konsumatorëve aktual.

● Uji i Pa-Faturuar (UPF)

Ujin e pafaturuar e përbëjnë humbjet fizike (përmes rrjedhjeve nga tubacionet) dhe humbjet komerciale (nga gabimet në leximin e ujmëmatësve dhe lidhjet ilegale). Humbjet fizike dhe komerciale të ujit nuk janë humbje vetëm për kompanitë por edhe humbje për konsumatorët. Për më tepër, kostoja për çdo litër ujë të humbur shkon huq për të cilën gjë në fund të fundit paguajnë vetë konsumatorët.

Uji i pafaturuar tani për tani llogaritet si përqindje e ujit të prodhuar dhe si litër për konsumatorë për ditë. Pasi që të dhënat e ofruara nga kompanitë janë të limituara, nuk është e mundur ndarja e UPF në humbje fizike dhe komerciale. ZRRUM konsideron se humbjet fizike dhe ato komerciale kanë proporcion të njëjtte në totalin e humbjeve prandaj përkrah çdo iniciativë të kompanive të ujit në adoptimin e një qasje strategjike të zgjidhjes së këtij problemi që do të adresonte të dy kategoritë e humbjes së UPF.

ZRRUM është mirënjohës për pjesëmarrjen e përfaqësuesve të disa kompanive të ujit në Konferencën mbi Humbjet të Ujit IWA të mbajtur në Bukuresht në shtator 2007 dhe i mirëpret reduktimet e dukshme në UPF pasi që secila kompani fillon implementimin e strategjisë për reduktimin e humbjeve të ujit.

Figura 7 tregon UPF në përqindje të prodhimit për çdo kompani ndërsa Figura 8 tregon UPF në litra për konsumator në ditë³.

Në 2007 UPF arrinë mesataren prej 58% të prodhimit të ujit në tërë sektorin por që variron ndërmjet kompanive nga 39% (Hidroregjionin Jugor) në 77% (Hidrodrini). Në 2007 kostoja nën hije (kostoja e ujit të pa faturuar) e paguar nga konsumatorët ka arritur shumë më prej gati 8 milion .

³Një konsumator konsiston në një pikë faturuese.




Figura 7 Uji i Pafaturuar (%)

Menaxhmenti i Hidrodrinit ka bërë identifikimin e shkaqeve të UPF së lartë dhe është duke punuar intenzivisht në përmirësimin e gjendjes.

Përqindja e ulët e UPF në Hidroregjionin Jugor mund të jetë rezultat i vlerësimit më të ulët të ujit të prodhuar. Sasia e raportuar e prodhimit të ujit në këtë kompani është kryesisht e bazuar në kalkulim dhe jo në matje.

ZRRUM-i konsideron që është e papranueshme që uji të mos matet saktësisht me ujëmatësit dhe do të insistojë që të sigurojë se Hidroregjioni Jugor do të instalojë ujëmatësit me qëllim të matjes së saktë të prodhimit të ujit në të ardhmen.

Në përgjithësi, UPF në nivel të sektorit është përmirësuar duke shënuar rënie nga 59% sa ka qenë në 2006 në 58% në 2007.

- **UPF (litra për konsumator në ditë)**

UPF i shprehur në litër për konsumator në ditë është njësi tjetër që ofron informacion se sa litra ujë të prodhuar nuk i sjellin kompanisë të ardhura.




Figura 8 Uji i pafaturuar (l/k/d)

Figura 8 tregon se në 2007 Hidrodrini mbetet ende shumë larg, me performancën më të dobët, me humbje të 2,753 litrave për konsumator në ditë, përderisa Ferizaj mbetet me performancën më të mirë me 407 litra për konsumator në ditë.

Në përgjithësi, UPF i shprehur në litër për konsumator në ditë ka shënuar përmirësim prej 1,143 litra për konsumator në ditë në 2006 në 1,025 në 2007.

ZRRUM-i konsideron që është papranueshme që të këtë dallime të theksuara (të pesëfishta) në UPF në mes të kompanive që kanë performuar më mirë dhe atyre më keq dhe pret nga kompanitë me performancë më të dobët (Hidrodrini dhe Radoniqi) të ndërmarrin hapa urgjent për të ulur UPF.

● Ankesat

Figura 9 paraqet mesataren e numrit të ankesave të marra nga çdo kompani për 1000 konsumatorë për shërbimet e ujit dhe kanalizimit. Treguesi është përlogaritur vetëm për ato kompani ku të dhënat e raportuara janë vlerësuar si të besueshme.

Ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket numrit të ankesave në mes të katër kompanive të paraqitura në diagram. Hidromorava ka numrin më të lartë të ankesave për 1000 konsumatorë në 7.36, në të cilën mund të kenë ndikuar ndërprerjet e gjata të furnizimit me ujë. Ndërsa plotësimi i standardit të furnizimit 24 orësh me ujë, dhe me kualitet të mirë mund të ketë ndikuar që Radoniqi të ketë shkallën më të ulët të ankesave për 1000 konsumatorë në 2.68.




Figura 9 Ankesat

Në përgjithësi (për katër prej shtatë kompanive të ujit), numri i ankesave për 1000 konsumatorë duket të ketë pësuar rritje enorme nga 0.81 në 2006 në 4.50 në 2007.

ZRRUM konsideron se ndryshimi i dukshëm prej vitit në vit mund të jetë rezultat i organizimit më të mirë të kompanive në regjistrimin dhe adresimin e ankesave dhe në ngritjen e vetëdijesimit të konsumatorëve lidhur me drejtat e tyre. Për më tepër, në një afat të shkurtër, ZRRUM do të shqyrtojë aranzhimet e çdo kompanie të ujit për regjistrimin dhe përgjigjen në ankesat e konsumatorëve.

● Norma e Punës dhe Norma e Mbulimit të Punës

Objektivi i secilës kompani të ujit është pa dyshim mbulimi i tërë kostos së prodhimit (kostos operative dhe kapitale përfshirë kthimin në kapital) përmes të ardhurave të realizuara bazuar në tarifata e përcaktuara nga ZRRUM. Në ekonomitë në tranzicion, siç është rasti me Kosovën, ky tregues mund të arrihet në një afat më të gjatë, duke filluar së pari me mundësinë e mbulimit të kostos operative.

Norma e punës është një tregues që pasqyron aftësinë financiare të organizatës të mbulojë kostot e operimit pa amortizim. Këtu merren parasysh të ardhurat e faturuara nga ofrimi i shërbimeve të furnizimit me ujë dhe të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve tjera operative.




Figura 10 Norma e punës

Në përgjithësi, në 2007 krahasuar me 2006, mesatarja e normës së punës ka shënuar zvogëlim prej 1.72 në 1.63. Norma më e ulët e punës në Hidromoravë në 2007 krahasuar me 2006 është rezultat i zvogëlimit të të ardhurave operative, përderisa në Prishtinë, Ujësjellësin Regjional, Hidroregjion Jugor dhe Hidrodrin vjen si rezultat i rritjes më të theksuar të shpenzimeve operative pa amortizim përkundër rritjes së të ardhurave. Rritja e të ardhurave në krahasim me shpenzimet operative ka bërë që ky tregues të duket më mirë në 2007 krahasuar me 2006 në Radoniq dhe Bifurkacion.

Norma e mbulimit të punës është tregues më i mirë i gjendjes së vërtetë financiare të kompanive meqë merren parasysh vetëm të ardhurat kesh të realizuara gjatë vitit fiskal.




Figura 11 Norma e mbulimit të punës

Në 2007 Hidromorava, Ujesjellësi Regjional dhe Hidrodrini, pa dyshim do të mund të identifikohen si kompani me performancë jo-efikase financiare d.m.th. me normë të mbulimit të punës më pak se 1.0. Këto kompani duhen të jenë të vetëdijshme se ky jo-efikasitet në afat të gjatë mund të çojë në pamundësinë e ofrimit të shërbimeve cilësore dhe asesi në zgjerimin e këtyre shërbimeve. Për dallim prej tyre, kompanitë financiarisht më të forta siç janë Radoniqi, Prishtina dhe Ferizaj do të mund të mbështesin operacionet efikase dhe të sigurojnë shërbime kundrejt standardeve. Kjo do të mund të kontribuojë për të mirëmbajtur më mirë shërbimet e tanishme dhe në përmirësimin e shërbimeve, investimet dhe në fund në kënaqjen e konsumatorit.

ZRRUM konsideron se të hyrat kesh në të gjitha kompanitë duhet të rriten dukshëm kryesisht përmes rritjes së efikasitetit të arkëtimit.

● Kostoja e Operimit për Njësi

Figura 12 paraqet koston e operimit për m³ të ujit të prodhuar për çdo kompani.

Në 2007 krahasuar me 2006 të gjitha kompanitë e ujit, përveç Hidrodrinit që ka mbetur stabil, kanë treguar rritje në koston e operimit për njësi. Rritja në koston operative mund t'i atribuohet rritjeve të dukshme në koston e energjisë në 2007 krahasuar me 2006.




Figura 12 – Kostoja e operimit për m³ ujë të prodhuar

Nga figura 12 mund të vërehet se ekziston një amplitudë e gjerë sa i përket koston së operimit për njësi. Hidrodrini ka nivel dukshëm më të ulët të koston se të gjitha kompanitë tjera të ujit dhe kurrfarë rritje nga viti 2006 në 2007. Meqenëse kostoja e operimit ndikohet nga lloji i sistemit të furnizimit (p.sh. pompimi ose varësisht nga trajtimi që nevojitet). Komponenti më i rëndësishëm nga koston e përgjithshme operative është zakonisht energjia elektrike. Për raportin 2008, ZRRUM do ta llogarisë dhe vlerësoj këtë tregues pa i përfshirë koston e energjisë, me qëllim që krahasimi dhe vlerësimi të jetë më i drejtë dhe më domethënës.

Në përgjithësi, kostoja e një njësie të ujit të prodhuar (m³) në 2007 krahasuar me 2006 ka shënuar rritje për EUR 0.02.

● Shkalla e Arkëtimit

Figura 13 paraqet shkallën e arkëtimit që kanë realizuar kompanitë e ujësjellësit në vitin 2007.

Shkalla më e ulët e arkëtimit në 2007 identifikohet prapë me Ujësjellësin Regjional, Mitrovicë në krahasim me kompanitë tjera. Gjithashtu në 2007 një pjesë e konsiderueshme e të hyrave, që do të duhej të grumbulloheshin nga konsumatorët e regjistruar si raste sociale, nuk janë arkëtuar për arsye të mos funksionimit të duhur të sistemit të sigurimit të asistencës financiare për rastet sociale nga ana e Qeverisë/Ministrive përkatëse.




Figura 13 –Efikasiteti i arkëtimit

Përmirësimet më të dukshme nga 2006 në 2007 (për 7%) janë arritur në Hidroregjionin Jugor dhe Bifurkacion si rezultat i implementimit të politikës së shkyçjes dhe në Hidroregjionin Jugor si rezultat i iniciativave të përmirësuara të arkëtimit.

Në përgjithësi, shkalla e arkëtimit është rritur prej 57% në 2006 në 61% në 2007, e cila edhe pse është pozitive është mjaft nën atë që ZRRUM e konsideron të nevojshme për një qëndrueshmëri financiare. Në këtë kontekst, ZRRUM pret që kompanitë të demonstrojnë një angazhim më të madh në ngritjen e shkallës së arkëtimit duke aplikuar masa adekuate legale dhe financiare. Në mënyrë më specifike ZRRUM-i pret nga kompanitë të implementojnë procedura më të rrepta të shkyçjeve ndaj konsumatorëve të cilët nuk paguajnë faturat e tyre në 2008 si dhe të ndërmarrin iniciativa për të ngritur shkallën e arkëtimit, p.sh. duke kontraktuar këtë aktivitet sektorit privat.

● Vlerësimi i Performancës së Përgjithshme - 2007

Kjo pjesë e raportit ekzaminon performancën e përgjithshme të kompanive të ujit në 2007. Vlerësimi është bazuar në TKP zgjedhur. Përshkrimi detaj i arsyeshmërisë së këtij vlerësimi së bashku me rezultatet e detajizuara mund të gjendet në Shtojcën B. Llogaritjet janë bërë bazuar në performancën relative ku nota e lartë tregon performancën më të mirë në grupin e kompanive të ranguar, por jo edhe performancën më të kënaqshme.

Tabela 1 pasqyron, në përgjithësi, vlerësimet e performancës për shtatë kompanitë regjionale të ujit për 2007. Radoniqi ka performancën më të mirë me 3.8 pikë nga maksimum 5.0 pikë. Në ekstremin tjetër, performanca e Ujësjiellit Regjional - Mitrovicë dhe Hidrodrinit kanë qenë mjaft nën performancën e pritur, pasi që kanë më pak se 2.5 pikë.

Tabela 1 –Vlerësimi i performancës së përgjithshme në 2007

Pozita	Kompanitë e ujësjiellit	Total
1	Radoniqi, (Gjakovë)	3.8
2	Prishtina, (Prishtinë)	3.6
3	Hidroregjioni Jugor, (Prizren)	3.1
4	Hidromorava, (Gjilan)	3.0
5	Bifurkacioni, (Ferizaj)	2.7
6	Hidrodrini, (Pejë)	2.2
7	Ujësjielli Regjional, (Mitrovicë)	1.9

● Përmirësimi i Përgjithshëm i Performancës, nga 2006 - 2007

E njëjta qasje është përdorur për të pasqyruar rangimin e performancës së kompanive nga më e mira te më e dobëta në lidhje me zhvillimet e ndodhura prej vitit 2006 në 2007.

Tabela 2 –Përmirësimet e përgjithshme në 2006-2007

Pozita	Kompanitë e ujësjiellit	Total
1	Hidroregjioni Jugor, (Prizren)	3.4
2	Hidrodrini, (Pejë)	3.3
3	Radoniqi, (Gjakovë)	3.2
4	Ujësjielli Regjional, (Mitrovicë)	3.0
5	Prishtina, (Prishtinë)	2.8
6	Bifurkacioni, (Ferizaj)	2.7
7	Hidromorava, (Gjilan)	2.1

Tabela 2 përmbledh vlerësimin e përmirësimeve të bëra gjatë 2007 krahasuar me 2006.

Përmirësimet më të dukshme vërehen në Hidroregjionin Jugor dhe këtë në cilësinë e ujit dhe në arkëtim. Kontinuiteti i furnizimit me ujë ka mbetur në kuotën maksimale, ndërsa në koston për njësi ka pasur keqësim.

Përmirësime të kufizuara në këta tregues janë bërë në Hidromoravë dhe Bifurkacioni. Kompania me performancë më të dobët në 2007 krahasuar me 2006 është Hidromorava.

● **Përmirësimet e Përgjithshme të Sektorit në 2007 krahasuar me 2006**

Ky raport poashtu krahason performancën e sektorit në 2007 me 2006 për të parë se a është përmirësuar sektori. Edhe këtu janë përdorur pesë TKP e njëjtë si në krahasimet e lartë paraqitura.

Tabela 3 përmbledh performancën e sektorit në përgjithësi, ku katër nga pesë TKP kanë shënuar përmirësim në vitin 2007 krahasuar me vitin 2006: kualiteti i ujit, efikasiteti i stafit, UPF dhe arkëtimi. Ndërkaq kostoja për njësi është më e lartë (trend negativ) dhe kjo mund të justifikohet me ngritjen e koston së energjisë elektrike si pasojë e ngritjes së tarifave të energjisë elektrike që kanë ndodhur.

Tabela 3 – Performanca e përgjithshme e sektorit 2006 - 2007

TKP	Përmirësim / Rënie	Shkalla e përmirësimit
Kualiteti i ujit	☺	Prej 4.1% në 3.2% shka. të dështimit (mospërbushjes)
Efikasiteti i stafit	☺	Prej 7.57 në 7.32
Kostoja për njësi	☹	Prej 0.08 në 0.10 EUR/m ³
UPF	☺	Prej 1,143 në 1,025 litra për konsumator në ditë
Arkëtimi	☺	Prej 57% në 61%

☺ - përmirësuar

☹ - pa ndryshime

☹ - rënie

Kapitulli 3

Performanca e Sektorit të Ujit me Shumicë

Kompania për ofrimin e furnizimit të ujit me shumicë (NH 'Iber-Lepenc', SH.A.)

Kompania e vetme e licencuar që ofron shërbimet e furnizimit të ujit me shumicë për kompanitë e ujësjellësit është NH 'Iber-Lepenc', SH.A. Kjo kompani ofron ujë me shumicë për Ujësjellësin Regjional në Mitrovicë dhe kompaninë Prishtina (për komunën e Gllgovcit).

● Standardet e Performancës

Përgjegjësitë e ZRRUM përfshijnë rregullimin ekonomik të ofruesve të shërbimeve të ujit me shumicë në pajtim me Nenin 1 të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49. Natyra e ndryshme e shërbimeve të ujit me shumicë krahasuar me shërbimet e ujësjellësit nënkupton që standardet e aplikueshme të shërbimit për shërbimet e ujit me shumicë janë të kufizuara në krahasim me kompanitë e ujësjellësit dhe rrjedhimisht përgjegjësia e ZRRUM-it kryesisht kufizohet në përcaktimin e tarifave.

● Treguesit e përdorur në këtë raport

Standardet teknike dhe shërbimit me konsumatorë

Nuk ka standarde të aplikueshme.

Treguesit financiar

Vlerësimi i performancës financiare në vijim do të jetë i mundur përmes shqyrtimit të katër treguesve:

- Shkalla e arkëtimit
- Kostoja e operimit për një m³ ujë të furnizuar
- Norma e punës
- Norma e mbulesës së punës

Përmirësimi i performancës

Të dhënat e raportuara nga kompania në ZRRUM mundësojnë për herë të parë analizën e performancës në 2007. Të dhënat për 2006 nuk janë në dispozicion.

- **Performanca financiare**

Performanca financiare e NH 'Iber-Lepenc',SH.A. është përmbledhur në Tabelën 4

Tabela 4 –performanca financiare e NH 'Iber-Lepenc', SH.A. (2007)

Treguesi	Vlera
Norma e punës	1.4
Norma e mbulesës së punës	0.2
Shkalla e arkëtimit (%)	15%
Kostoja e operimit për njësi (EUR / m ³)	EUR 0.013

Kapitulli 4

Performanca e Sektorit të Mbledhjes së Mbeturinave

Standardet e Performancës

Rregullorja e UNMIK-ut 2004/49 (Neni 11 (c)) parasheh standardet e mëposhtme për aplikim në ofrimin e shërbimeve të mbeturinave:

- Orari dhe shpeshtësia e mbledhjes së mbeturinave
- Densiteti i kontejnerëve komunal
- Mirëmbajtja e vendit ku mbledhen mbeturinat
- Parandalimi i copëzave të mbeturinave nga fluturimi dhe shkapërderdhja.

Standardet e specifikuar siç janë përcaktuar në Rregullore janë paraqitur në Shtojcën

D.Fatkeqësisht, asnjë nga standardet për shërbim të paraqitura në Rregulloren e UNMIK-ut 2004/49 në vitin 2007 nuk janë shqyrtuar për shkak të mungesës së vazhdueshme të të dhënave nga kompanitë e mbeturinave.

● Treguesit e Përdorur në këtë Raport

Standardet teknike dhe shërbimit me konsumatorë

Vlerësimi i performancës në këtë pjesë të raportit është limituar në një numër të caktuar të treguesve si pasojë e disponimit të limituar të të dhënave nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave.

Në praktikë është shumë vështirë të matet në mënyrë të drejtë mirëmbajtja e vendit ku mbledhen mbeturinat dhe parandalimi i copëzave të mbeturinave nga fluturimi dhe shpërndarja. Për këtë arsye në këtë raport janë shqyrtuar treguesit vijues për të cilët të dhënat për 2007 janë në dispozicion:

- Shtrirja e shërbimeve
- Mbeturinat e mbledhura për punëtor
- Përqindja e mbeturinave të deponuara në deponitë e licencuara
- Efikasiteti i stafit
- Ankesat e konsumatorëve

Treguesit financiar

Vlerësimi i performancës financiare në vijim do të jetë i mundur përmes shqyrtimit të katër treguesve financiar:

- Norma e punës
- Norma e mbulimit të punës
- Shkalla e arkëtimit
- Kostoja e operimit për ton të mbeturinave të grumbulluara.

Të dhënat e raportuara nga kompanitë në ZRRUM mundësojnë analizën e trendeve të performancës në 2007 krahasuar me 2006.

● Shtrirja e shërbimeve

Figura 14 paraqet shtrirjen e shërbimeve, ku bëhet krahasimi i numrit të popullatës së shërbyer me numrin total të popullatës në zonën e shërbimit.




Figura 14 – Shtrirja e shërbimeve

Mbulimi me shërbime nga shtatë kompanitë e grumbullimit të mbeturinave mbetet i vogël dhe karakterizohet me një amplitudë të gjerë në mes tyre. Në bazë të informacioneve të pranuara nga kompanitë një pjesë e madhe e popullatës në zonat rurale aktualisht nuk shërbehen nga kompanitë regjionale të grumbullimit të mbeturinave.

ZRRUM edhe më tutje rekomandon që ngritja e shkallës së shtrirjes së shërbimeve të mbetet objektiv afat-gjatë për tërë sektorin.

Në 2007 krahasuar me 2006, mesatarja e shtrirjes së shërbimeve nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave ka mbetur e pandryshuar në 44%.

- **Mbeturinat e Grumbulluara për Punëtor**

Figura 15 paraqet shumën totale të mbeturinave të grumbulluara për punëtor (ton në vit).

Në përgjithësi, mesatarja e mbeturinave të mbledhura për punëtor në vitin 2007 ka qenë 156 ton.




Figura 15 – Mbeturinat e mbledhura për punëtor

Në 2007 krahasuar me 2006 shifrat paraqesin kryesisht rritje të efikasitetit të grumbullimit të mbeturinave në katër prej shtatë kompanive të mbeturinave. Rritja e efikasitetit të grumbullimit në Unitet, Higjienë dhe Ambient ka ardhur kryesisht si rezultat i zvogëlimit të numrit të punëtorëve, përkundër rritjes jo aq të theksuar të sasisë së mbeturinave. Ndërsa Çabrati ka qenë më efikas në punë me numër të njëjtë të punëtorëve. Rënia e efikasitetit të stafit në Pastrim dhe Eko-regjion është për shkak të rritjes së numrit të punëtorëve por edhe zvogëlimit të sasisë së grumbulluar të mbeturinave. Në të dy regjionet e këtyre kompanive pjesëmarrja e operatorëve privat në grumbullimin e mbeturinave (kryesisht shërbimet profitabile të grumbullimit të mbeturinave të konsumatorëve komercial) ka qenë më e madhe se në 2006.

Mesatarja e sektorit për 2007 nuk ka qenë e mundur të tregohet pasi që të dhënat për njërin nga kompanitë (Pastërtia) nuk janë në dispozicion.

Për më tepër, në këtë tregues ndikojnë edhe faktorë tjerë si: karakteristikat regjionale (urban/rural), numri i automjeteve funksional për grumbullim dhe distanca e transportimit deri në deponi regjionale.

- **Përqindja e Mbeturinave të Deponuara në Deponi të Licensuara**

Përqindja e mbeturinave të deponuara në deponitë regjionale të licencuara është paraqitur në Figura 16.




Figura 16 – Mbeturinat e deponuara në deponi

Edhe në 2007 regjioni i Gjakovës mbetet pa deponi regjionale të licencuara, Çabrati të tërë sasinë e mbeturinave e ka hedhur në deponi të egra. Ndërsa Higjiena, Pastrimi dhe Uniteti, në bazë të të dhënave të tyre, i shfrytëzojnë vetëm deponitë e licencuara për hedhjen e mbeturinave.

● Efikasiteti i Stafit




Figura 17 –Efikasiteti i stafit

Figura 17 paraqet efikasitetin e stafit (staf për 1000 konsumatorë) për çdo kompani. Pasi që kostoja e stafit është kostoja më e lartë operative, kompanitë do të duhej të përqendroheshin në përmirësimin e efikasitetit të stafit në mënyrë që të ulen shpenzimet operative.

Efikasiteti i ulët i stafit në kompanitë e grumbullimit të mbeturinave sikur te kompanitë tjera të ofrimit të shërbimeve publike duket të jetë fenomen përcjellës edhe për këtë vit në Kosovë.

Rasti i efikasitetit të ulët në Unitet, përkundër përmirësimit prej viti në vit, do të subjekt hulumtimi për ZRRUM në muajt e ardhshëm.

Në përgjithësi, efikasiteti i stafit në 2007 krahasuar me 2006 është rritur (trend pozitiv) për 0.62.

● Ankesat e Konsumatorëve

Të dhënat për ankesat e konsumatorëve janë treguar në [Figurën 18](#). Siq vërehet nga figura e mëposhtme ka qenë i pamundur grumbullimi i të dhënave të besueshme nga shumica e kompanive të mbeturinave për shkak të mosfunksionimit të duhur të sistemeve të tyre të menaxhimit me ankesat.

ZRRUM shpreson që të dhënat e relacioneve me konsumatorë për 2008 do të jenë më të besueshme duke u bazuar në informacionin e marrë nga kompanitë se së shpejti ato do të pajisen me një pako të re softuerike të sistemit të menaxhimit të informacioneve pjesë e së cilit do të jetë edhe moduli i Relacionit me Konsumatorë.




Figura 18 – Ankesat

- **Norma e Punës dhe Norma e Mbulimit të Punës**

Norma e punës është një tregues që pasqyron aftësinë financiare të organizatës të mbulojë kostot e operimit pa amortizim. Këtu merren parasysh të ardhurat e faturuara nga ofrimi i shërbimeve të grumbullimit të mbeturinave dhe të ardhurat nga ofrimi i shërbimeve tjera operative.




Figura 19 –Norma e punës

Norma e punës, e paraqitur në [Figurën 19](#), sillet prej 1.13 deri në 2.0.

Norma e ulët e punës në Eko-regjion, Higjienë e sidomos në Unitet kërkon rishqyrtim të tarifave dhe faktorëve tjerë ndikues në periudhën vijuese të raportimit. Edhe sikur norma e arkëtimit të këtyre kompanive do të ishte 100% ato do të tejkalonin shumë pak kufirin e mbulimit të shpenzimeve operative.

Në përgjithësi, ZRRUM, bazuar në të gjeturat e procesit të auditimit të të dhënave të raportuara, konsideron se një faktorë tjerë ndikues në uljen e nivelit të këtij treguesi mund të jetë faturimi fiktiv (më tepër sqarime do të sigurohen në komentet mbi treguesin e shkallës së arkëtimit).

Edhe përkundër zhvillimeve rritëse/rënëse nga viti në vit të këtij treguesi nëpër kompani, mesatarja e sektorit ka mbetur pothuajse stabile.

Norma e mbulimit të punës pasqyron aftësinë e kompanisë në mbulimin e kostos operative nga të ardhurat kesh.




Figura 20 – Norma e mbulimit të punës

Figura 20 tregon se për pesë nga shtatë kompanitë e grumbullimit të mbeturinave norma është më poshtë se 1.0 që pasqyron gjendje negative financiare dhe nevojë për subvencionim. Të tri kompanitë që kanë përformuar më keq se mesatarja e sektorit mund të arsyetohen me normën e ulët të punës. Dy kompanitë me normë të mbulimit të punës mbi 1.0 janë në një situatë paksa më të mirë por ende nuk janë në gjendje të plotësojnë nevojat e veta financiare për investime kapitale.

Në përgjithësi, norma e mbulimit të punës në 2007 krahasuar me 2006 është ngritur për 0.10.

● **Shkalla e Arkëtimit**

Figura 21 tregon për një përmirësim të dukshëm të shkallës së arkëtimit në 2007 krahasuar me 2006 për 11% pikë. Ky duket të jetë treguesi i vetëm në të cilën të shtatë kompanitë e grumbullimit të mbeturinave kanë shënuar progres.




Figura 21 – Shkalla e arkëtimit

Në vitin 2007 shkalla e arkëtimit si mesatare e sektorit të grumbullimit të mbeturinave është për 10% më e lartë krahasuar me mesataren e sektorit të ujit. ZRRUM konsideron se shkalla e arkëtimit e raportuar për kompanitë e grumbullimit të mbeturinave është fiktive pasi që shumica e këtyre kompanive i faturojnë disa kategori të konsumatorëve në momentin kur të bëhet realizimi i të hyrave nga këta konsumatorë. Kjo procedurë nuk përdoret nga kompanitë e ujit dhe asesi nuk është në përputhje me SKK.

● Kostoja e Operimit për Njësi

Figura 22 paraqet koston e operimit për ton të mbeturinave të mbledhura. Në 2007 kostoja e operimit ndryshon dukshëm prej kompanisë në kompani dhe nuk mund të shpjegohet me dukurinë e shkallës së ekonomizimit.

Në 2007 rritja e shpenzimeve operative për njësi në Pastrim është rezultat i shtimit të shpenzimeve të deponimit, d.m.th. në 2007 e tërë sasia e mbeturinave është deponuar në deponinë e licensuar e cila është nën menaxhimin e KLMC krahasuar me 2006 ku vetëm 2% janë deponuar në deponinë e licencuar.

Në Eko-regjion rritja e shpenzimeve prej vitit në vit ka ardhë kryesisht si rezultat i zvogëlimit të mbeturinave të grumbulluara përdërisa numri i punëtorëve ka mbetur i njëjtë.

Mesatarja e përgjithshme e koston së mbeturinave të mbledhura për gjashtë nga shtatë kompanitë e grumbullimit të mbeturinave për vitin 2007 është 36 EUR për ton.




Figura 22 – Kostoja e operimit për njësi

● Vlerësimi i Përgjithshëm i Performancës - 2007

Kjo pjesë e raportit shqyrton performancën e përgjithshme të kompanive të licensuara që sigurojnë shërbime të grumbullimit të mbeturinave. Vlerësimi bazohet në TKP e zgjedhur. Përshkrimi detaj i arsyeshmërisë së këtij vlerësimi së bashku me rezultatet e detajizuara është dhënë në Shtojcën B. Llogaritjet janë bërë bazuar në performancën relative ku nota e lartë tregon performancën më të mirë në grupin e kompanive të ranguar, por jo edhe performancën më të kënaqshme.

Tabela 5 përmbledh rezultatet e këtij vlerësimi të performancës në përgjithësi. Kompania për grumbullimin e mbeturinave me performancë më të mirë në 2007 është Uniteti që ka 1.9 pikë nga maksimum 2.0. Në anën tjetër Ambienti dhe sidomos Higjiena kanë shënuar më pak se 1.0 që paraqet performancë më pak se të kënaqshme.

Tabela 5 – Vlerësimi i performancës së përgjithshme të kompanive në 2007

NP	Kompania e Grumbullimit të Mbeturinave	Total
1	Uniteti, Mitrovicë	1.8
2	Cabrati, Gjakovë	1.7
3	Pastrimi, Prishtinë	1.2
4	Pastërtia, Ferizaj	1.0
5	Eco-Regjioni, Prizren	1.0
6	Ambienti, Pejë	0.9
7	Higjiena, Gjilan	0.2

● Përmirësimi i Përgjithshëm i Performancës së Kompanive 2007 - 2006

E njëjta qasje është përdorur për të pasqyruar rangimin e performancës së kompanive nga më e mira në më të dobtenë në lidhje me zhvillimet e ndodhura prej vitit 2006 në 2007.

Tabela 6 – Përmirësimet e përgjithshme të performancës së kompanive në 2007 krahasuar me 2006

NP	Kompania e Grumbullimit të Mbeturinave	Total
1	Uniteti, Mitrovicë	1.1
2	Cabrati, Gjakovë	1.1
3	Ambienti, Pejë	1.0
4	Eco-Regjioni, Prizren	1.0
5	Higjiena, Gjilan	1.0
6	Pastrimi, Prishtinë	0.3
7	Pastërtia, Ferizaj	0.1

Tabela 6 përmbledh vlerësimin e përmirësimeve të bëra gjatë 2007 krahasuar me 2006. Përmirësimet më të dukshme vërehen në Unitet me 1.17 dhe në Çabrat me 1.06.



Në Pastërti dhe Patrim përmirësimet në këta tregues kanë qenë shumë të vogla.

● Përmirësimet e Përgjithshme të Sektorit 2007 - 2006

Ky raport poashtu krahason performancën e sektorit në 2007 me 2006 për të parë se a është përmirësuar sektori. Edhe këtu janë përdorur dy TKP e njëjtë si në krahasimet e lartë paraqitura për performancën e vitit 2006.

Tabela 7 përmbledh performancën e sektorit në përgjithësi, ku arkëtimi ka treguar përmirësim të dukshëm ndërsa mesatarja e kostos për njësi është më e lartë (trend negativ).

Tabela 7 –Performanca e përgjithshme e sektorit 2007 - 2006

TKP	Përmirësim / Rënie	Shkalla e përmirësimit
Kostoja për njësi		Prej 29.60 në 36.24 EUR/ton
Arkëtimi		Prej 60% në 71%

Kapitulli 5

Performanca e Sektorit të Deponimit të Mbeturinave

Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KLMC)

Kompania e menaxhimit të deponive të Kosovës (KLMC) është operatori i vetëm i licencuar nga ZRRUM për të operuar me deponitë. KLMC operon katër deponitë e financuara nga AER në: Prishtinë, Podujevë, Prizren dhe Gjilan përmes operatorëve privat të kontraktuar.

Vlerësimi i performancës së KLMC është bërë i mundur përmes të dhënave të pranuar nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave dhe KLMC për 2007.

● Deponitë e Licencuara

Shumica e konsumatorëve të KLMC (por jo të gjithë) janë kompanitë regjionale të grumbullimit të mbeturinave për zonat e shërbimit në Prishtinë, Gjilan, Ferizaj dhe Prizren dhe një numër i operatorëve privat ndërkombëtar dhe vendor. Dy nga kompanitë e grumbullimit të mbeturinave, Uniteti dhe Ambienti përdorin deponitë e licencuara komunale d.m.th. jashtë menaxhimit të KLMC. Ndërsa Çabрати, vazhdon të deponoj mbeturinat në deponi të palicencuara.

